

AKT THEMELIMI
i Shoqerise me Përgjegjesi te Kufizuar
“Blue Beach Restaurant” SH.P.K.

Ortaku themelues si më poshtë:

Z. Ardjan Alimeri, shtetas shqiptare, i datëlindjes 12.07.1969, lindur në Çorovodë dhe banues Bulevardi Bajram Curri ,Pall:Firma Frenkli ,Tirane, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal G90712054C; bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, sot më datë 01.11.2021, harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

KREU I
Emri, Objekti, Kohezgjatja, Zyra Qendrore

Neni 1

Emri

1.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “Blue Beach Restaurant”.

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

Neni 2

Forma

2.1 Shoqëria tregtare “Blu Beach Restaurant”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 3

Objekti

3.1 Bar restorant, stacione plazhi - dhenie shezllonesh me qira.

3.2 Gjithashtu shoqëria mund të ushtroj edhe çdo lloj aktiviteti tjetër të pashprehur me sipër, që lejohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 4

Kohezgjatja

4.1. Kohezgjatja e shoqërisë do të jete e pacaktuar.

Neni 5

Zyra Qendrore

5.1 Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet në Durres në adresën: Rruga Draç, Ndertesa në zonën kadastrale 1522, Nr. Pasurie 129/64 ND, Lalez.

KREU II
Kapitali, Përgjegjësia e Ortakëve

Neni 6

Kapitali i regjistruar

6.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 100.000 (njqindmije) leke, i përbërë nga 1 (një) kuotë me vlerë 100.000 leke, kuote e cila zotërohet nga ortaku i vetëm Ardjan Alimeri.



6.2. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/te paluajtshme apo të drejta).

Neni 7
Përgjegjësia e Ortakëve

7.1 Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara prej tyre.

KREU II
Organet e shoqërisë, Administratori, Sekretit Tregtar

Neni 8
Organet e Shoqërisë

8.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

8.2 Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Neni 9
Administratori

9.1 Asambleja e përgjithshme emeron një ose më shumë persona fizike si administratore të shoqërisë. Afati i emerimit, është 2 vjet, me të drejtë ripërteritjeje. Emerimi i administatorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit. Administrator i parë Shoqërisë është ortakë z. Ardjan Alimeri.

Neni 10
Sekretit tregtar

10.1 Ortakët, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë "Blue Beach Restaurant" SHPK përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

Neni 11

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës kompetente.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 3 (tre) origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

Ardjan Alimeri

Ardjan Alimeri

